



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE**

UDHËZIM PLOTËSUES

Nr. 101, Datë 28/02/2017

“PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT VENDOR”

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe pikës 64 të Udhëzimit nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Ministri i Financave:

U D H Ë Z O N :

I. Të përgjithshme

Ky udhëzim përmban:

- tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2018-2020;
- transfertën e pakushtëzuar dhe specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- procedurat dhe afatet e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2018-2020;
- mënyrën e llogaritjes së transfertave të pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

II. Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm

- Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 për çdo program, miratohen nga Këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore brenda muajit Mars 2017.
- Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2018-2020, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.47 datë 25.01.2017, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të njesisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që njësia vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të përcaktuar Tavanet e Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2018-2020, për përcaktimin e nivelit të pagave bazohen në kuadrin ligjor të miratuar gjatë vitit 2017.

III. Transferta e pakushtëzuar dhe specifike e njësive të vetëqeverisjes vendore

- Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për vitet 2018-2020, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2017. Për transferimin e funksioneve që mund të

bëhen në të ardhmen niveli i tranferts së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

- Transferta e pakushtëzuar do të rritet në vitin 2018 me 2 përqind, me 5.4 përqind në vitin 2019 dhe për vitin 2020 me 10.3 përqind.

në mijë lekë

Vitet	2018	2019	2020
Transferta e Pakushtëzuar	13,750	14,500	16,000

- Në transfertën specifike për periudhën 2018-2020 do të përfshihen efektet financiare për rritjen e pagave në njësitë e vetëqeverisjes vendore bazuar në kuadrin ligjor të miratuar në vitin 2017, për funksionet e reja transferuar buxhetit vendor nëpërmjet grantit specifik.

në mijë lekë

Vitet	2018	2019	2020
Granti Specifik	7,000	7,000	7,500

IV. Procedurat dhe afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020

- Kalendari i përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm miratohet nga Kryetari i Grupit për Menaxhim Strategjik (GMS) së Njesisë së Qeverisjes Vendore.
- Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programit, paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat shtesë sipas programit tek nëpunësi autorizues i NjQV-së, brenda datës 15 Maj 2017.
- Kërkesat buxhetore të dorëzuara te Njësia Autorizues i Njesisë së Qeverisjes Vendore vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik i Njesisë së Qeverisjes Vendore.
- Njësia Autorizues i Njesisë së Qeverisjes Vendore paraqet pranë këshillit të njesisë së qeverisjes vendore dokumentin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2018-2020, të miratuar nga Grupi për Menaxhim Strategjik, brenda datës 15 Qershor 2017.
- Afati i dorëzimit të kërkesave buxhetore bashkë me kërkesat shtesë nga Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të çdo programi te Njësia Autorizues i Njesisë së Qeverisjes Vendore është 15 Maj 2017.
- Kurset e këmbimit për vitet 2011-2017, dhe parashikimi për vitet 2018-2020, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2018	2020
1	Kurs i këmbimit mesatar Lek/USD	100.9	108.2	105.7	105.5	126.0	124.1	124.1	124.1	124.1	124.1
2	Kurs i këmbimit mesatar Lek/EURO	140.5	139.0	140.3	140.0	139.7	137.4	137.4	137.4	137.4	137.4

- Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, dërgohet në këshillin e njesisë së vetëqeverisjes vendore në muajin Qershor 2017.

- Brenda datës 1 Qershor 2017 çdo njësi e vetëqeverisjes vendore duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave, me shkrim dhe në rrugë elektronike:
 - a. tabelën nr.1 “Parashikimi i të ardhurave afatmesme të njesisë së vetëqeverisjes vendore”.
 - b. tabelën nr.2, “Parashikimi i shpërndarjes së burimeve financiare afatmesme për njësinë e vetëqeverisjes vendore”.
 - c. tabelën nr.3, “Formatet e planifikimit të tavanave afatmesme të shpenzimeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
 - d. tabelën nr.4, “Investimet afatmesme në nivel projekti”.
 - e. tabelën nr.5, “Kërkesat shitesë të programit buxhetor afatmesëm”.
 - f. tabelën nr.6, “Numri i punonjësve”.
 - g. Relacion shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm

V. Mënyrat e llogaritjes së transfertave të pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike për njësitë e qeverisjes vendore

5.1 Transferta e pakushtëzuar

- Madhësia e transfertës së pakushtëzuar përcaktohet në përqindje të të ardhurave publike faktike nga tatimet dhe doganat të një viti të mëparshëm.
- Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2018-2020 do të jenë po ata të vitit 2017. Në përlogarritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2017, janë marrë si kritere: popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censurit), dendësia e popullsisë për km², numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.
- Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore në mënyrë individuale mund të llogarisë nivelin e transfertës së pakushtëzuar, duke u bazuar në aneksin nr.1 të ligjit nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”.

5.2 Transferta specifike dhe e kushtëzuar

- Transferta specifike parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2018-2020, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara në njësitë e qeverisjes vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.
- Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2018-2020, për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara, ose të përbashkëta. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve

shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

6. Ndjekja e Procesit dhe Mbështetja Këshillimore

- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, vë në dispozicion për çdo Njësi të Vetëqeverisjes Vendore, adresat e e-mailit: Fran.Brahimi@financa.gov.al, Elidona.Durmishi@financa.gov.al, Mariel.Frroku@finannca.gov.al.
- Nëpunësi i parë autorizues nëpërmjet njësisë përgjegjëse për buxhetin vendor analizon kërkesat buxhetore të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe zhvillon takime konsultative me këto njësi sipas një kalendarit të paracaktuar. Takimet me njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë në fokus kërkesat buxhetore të lidhura me financimin e buxhetit qendror për pushtetin vendor.
- Bashkëlidhur udhëzimit, gjenden formatet për tu plotësuar nga çdo njësi e vetëqeverisjes vendore të shoqëruara me manualin shpjegues për plotësimin e tyre, dokumente të cilat duhet të dorëzohen në Ministrinë e Financave brenda datës 1 qershor 2017.

7. Të tjera

- Për procedura të detajuara mbi përgatitjen e kërkesave buxhetore, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore mund t'i referohen përcaktimeve të Udhëzimit nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të cilat mund të shkarkohen në linkun: <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR